

Ekskluzive

Ekskluzive | Municion luftarak në një stallë bagëtish në Zubin Potok, Policia sekuestron 374 fishekë



Sinjali.com

08 Korrik 2026 08:31



Një sasi e konsiderueshme municioni është zbuluar në një stallë bagëtish në fshatin Bube të Zubin Potokut, ndërsa Policia ka nisur hetimet për identifikimin e pronarit, raporton Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se rasti është zbuluar pas një informacioni të siguruar nga Njësia për Reagim të Shpejtë (NJRSH) – Veri, e cila ka ndërhyrë në lokacion rreth orës 16:35 të së hënës.

Gjatë kontrollit në stallën e bagëtive, zyrtarët policorë kanë gjetur dhe sekuestruar 315 fishekë të kalibrit 7.62 mm, 58 fishekë manovrues, si dhe një fishek të armës së gjatë, gjithsej 374 copë municion.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë edhe njësitë relevante të Stacionit Policor në Zubin Potok, të cilat kanë kryer ekzaminimet dhe kanë sekuestruar të gjithë municionin.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se deri më tani nuk është identifikuar pronari i stallës, ndaj rasti është iniciuar ndaj personave të panjohur për veprën penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”**.

Hetimet janë duke vazhduar për të zbuluar se kujt i përkiste municioni dhe si kishte përfunduar në atë lokacion.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukurí dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera